



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**STANDARDET PROFESIONALE
TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM
DHE LËNDOR
TË MËSUESIT TË ARSIMIT FILLOR**

SHTATOR 2016



Përmbajtja

| | |
|--|----------|
| PËRMBAJTJA | 1 |
| PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME | 2 |
| 1.1 Hyrje | 2 |
| 1.2 Përse vlejné këto standarde? | 3 |
| 1.3 Struktura e standardit | 5 |
| PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT TË ARSIMIT FILLOR | 6 |
| 2.1 Përshkrimi përmbledhës | 6 |
| 2.2 Organizimi i standardeve | 6 |
| 2.3 Standardet profesionale të mësuesit të ciklit fillor | 7 |


PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

1.1 Hyrje

Zbatimi i reformës kurrikulare bazuar në kompetenca kërkon ndryshimin e rolit të mësuesit dhe të shkollës, si dhe pritshmërinë ndaj tyre. Mësimdhënia dhe të nxëniet me kompetenca nuk zhvillohet në “vakum”, por kërkon mësues cilësisht të aftë për të lehtësuar të nxëniet e nxënësve të tyre, të përkushtuar ndaj tyre dhe nevojave të tyre, si dhe t’ju sigurojnë atyre strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxëniet sa më efektiv.

Paketa e zhvillimit profesional të mësuesve, pjesë e së cilës është dhe dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit, kërkon që zhvillimi profesional i mësuesve të ketë fokus të fuqishëm rezultatet e nxënësit. ***Pyetja që shtrohet është: Cili është ndikimi i mësimdhënies te nxënësit, pra sa efektive është mësimdhënia?***

Të gjithë mësuesve duhet t’u jepet mundësia të marrin pjesë në zhvillim profesional, gjë që i ndihmon ata “të ushqehen” dhe t’i përkushtohen nxënësve në progresin dhe suksesin e tyre. Zhvillimi intensiv i vazhdueshëm profesional i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm ndihmon mësuesit të “rriten” dhe të vlerësojnë ecurinë e performacës së tyre. “Mësuesia” është profesioni thellësisht më i rëndësishëm që ndikon në formimin e brezit të ardhshëm dhe duhet të formohet dhe të zhvillohet bazuar në standarde, të cilat përcaktojnë se çfarë duhet të dijë çdo mësues, çfarë aftësish duhet të demonstrojë dhe nga ç’vlera e qëndrime duhet të karakterizohet.




Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit, hartuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, ka për qëllim kryesor të përshkruajë një vizion të ri për mësimitdhënien, me fokus plotësimin e nevojave dhe të interesave individuale të nxënësit për dijen.

1.2 Përse vlejné këto standarde?

Standardet profesionale të mësuesit përshkruajnë atë që pritet të njohin, të kuptojnë, të zotërojnë dhe të demonstrojnë mësuesit, si specialistë në fushën e tyre.

a) Këto standarde i vlejné së pari, **vetë mësuesit**. Mësuesi mbështetet në to për të vlerësuar performancën e tij, duke dalluar anët e veta të forta dhe nevojat, si dhe për të kuptuar më mirë përparimin e tij profesional. Ato ndihmojnë që mësuesi në mënyrë individuale të menaxhojë vetë secilën nga fazat e mëposhtme:



Nëpërmjet këtyre standardeve mësuesi kupton *vizionin e ri për mësimitdhënien*, një panoramë të asaj se ku synohet të shkohet. Për të përmirësuar cilësinë e tij, mësuesi duhet të *identifikojë nevojat* e shkollës, në përgjithësi, por edhe të tijat, në veçanti. Standardet përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, për të cilat mësuesi tregon *angazhimin* për kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Secili në punën e tij punon duke pasur parasysh disa standarde që tregojnë sesa kompetent është ai në punë.

Nivelet e performancës tregojnë se sa një mësuesi i përmbush këto standarde. Në momentin që mësuesi e ka shumë të qartë se çfarë duhet të arrijë, ai punon për rritjen dhe

zhvillimin e tij profesional. Megjithëse mësues të ndryshëm kanë nevoja të ndryshme, përsëri ka fusha për të cilat të gjithë mësuesit e shkollës kanë nevojë për trajnime.

Përbushja e standardeve mbështet mësuesin për **progresin e tij në karrierë** dhe për kualifikimin e tij. Mësues me performancë të kënaqshme dhe me rezultate shumë të mira në kualifikim ndikon në arritjet progresive të nxënësve.

- b) Standardet profesionale të mësuesit ia lehtësojnë mjaft punën, **drejtuesit** të shkollës kur i duhet të përmbledhë nevojat profesionale të mësuesve e të menaxhojë pastaj, bashkë me ta, hartimin dhe zbatimin e planit të zhvillimit profesional të tyre. Gjithashtu, drejtuesit i vlejné edhe standardet profesionale lëndore për të vlerësuar periodikisht performancën e mësuesit, për të kuptuar ngritjen e tyre profesionale dhe për të gjetur ose për të porositur, bashkë me ta, formën e përshtatshme të zhvillimit profesional, si dhe literaturën e nevojshme profesionale. Vendimi për përzgjedhjen e një mësuesi në një institucion arsimor duhet të merret pas përgjigjes së pyetjes: **“Sa i përmbush kandidati treguesit e standardeve të mësuesit?”**.
- c) **Këshilli i mësuesve, ekipet lëndore, komisioni psiko-social** janë organizma të tjerë të shkollës, të cilët mund të përdorin këto standarde për t’u mbështetur në përmirësimin e klimës në shkollë, në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve. Tashmë, ato mund të përcaktojnë më mirë temat e diskutimeve e të debateve profesionale dhe të analizojnë më thellë arritjet e nxënësve, në saj të filozofisë që përshkruajnë këto standarde.
- d) Përfaqësuesve të **komunitetit të institucionit** d.m.th., Bordit të shkollës dhe Këshillit të prindërve u shërben shqyrtimi i standardeve për të kuptuar cilësinë e shërbimit arsimor që ofron shkolla.
- e) **Ministria e Arsimit dhe e Sportit** niset pikërisht nga këto standarde për të formuluar politikën mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit. Mbi këto standarde bazohet kualifikimi dhe trajnimi i mësuesve.
- f) **Instituti i Zhvillimit të Arsimit** identifikon nevojat e mësuesve për zhvillim profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar.
- g) **Inspektorati Shtetëror i Arsimit** ndihmon mësuesit në përbushjen e këtyre standardeve duke kryer vlerësimin e jashtëm të performancës së tyre.

- h) **Njësitë arsimore vendore** (DAR/ZA-të) mbështetur në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe sipas profileve hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.
- i) **Fakultetet e edukimit** mbështeten në këto standarde për të hartuar me koherencë standardet e formimit fillestar të mësuesve, si dhe kurrikulën përkatëse, referuar formimit shkencor sipas profilit dhe formimit të përgjithshëm, duke i përgatitur studentët për licencim.
- j) **Këshillat dhe shoqatat e mësuesve** kanë parasysh të dy llojet e standardeve për të veçuar ato nevoja profesionale, të cilat janë më të domosdoshme për t'u plotësuar në nivel shkolle, si dhe për të planifikuar veprimtarinë e zhvillimit profesional të mësuesve dhe këshillimin profesional të tyre.
- k) Po kështu, **OJF-të, donatorët** dhe shoqatat e interesuara për zhvillimin profesional të mësuesve kanë nevojë për një dokument të plotë të standardeve profesionale të mësuesit, në mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të për zgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

1.3 Struktura e standardit

Standardet profesionale të mësuesit janë pohime të cilat harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të mësuesit.

Struktura e standardit përmban titullin e tij dhe përshkrimin e përmbledhur të standardit. Ky standard zërthehet në *disa tregues të detajuar dhe të matshëm*, të cilët i referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi. Këta tregues vlerësohen sipas niveleve përkatëse, të përshkruara në këtë dokument.

PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT TË ARSIMIT FILLOR

2.1 Përshkrimi përmbledhës

Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit janë hartuar duke u bazuar në dokumente rekomanduese¹ hartuar nga Komisioni Evropian. Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përmbushur dhe në ç'shikullë është përmbushur një standard i caktuar.

Standardet nuk mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë të ndërlydhura dhe duhen menduar si një e tërë, ku secili standard, bashkë me treguesit e tij, vështron një aspekt të rëndësishëm të mësuesit cilësor.

Standardet e mësuesit të ciklit fillor përshkruajnë karakteristikat themelore të një mësuesi cilësor në mënyrë të përmbledhur, të qartë dhe e bëjnë dokumentin lehtësisht të përdorshëm. Ato vijnë si rezultat i kërkimeve dhe i përvojave më të fundit në fushën e zhvillimit profesional që kanë ndodhur në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare.

Standardet mbrojnë personalitetin e mësuesit cilësor dhe ndikojnë ndjeshëm në rritjen e përkushtimit të tij për profesionin që ushtron. Mësuesi, duke u mbështetur te standardet, mund të bëjë vetë një vlerësim të profesionalizmit të tij për të konfirmuar nivelin ku ndodhet, përmirësimet që duhet të bëjë dhe të hartojë planin e zhvillimit profesional.

2.2 Organizimi i standardeve

Dokumenti përmban 7 standarde të cilat lidhen me angazhimin, interesin dhe përfshirjen e mësuesit në veprimtari trajnuese dhe kualifikuese; me zotërimin e përmbajtjes shkencore të lëndëve të ciklit fillor; me krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili ndihet i mirëpritur dhe i mirëseardhur; me krijimin e një klime pozitive dhe me përdorimin e teknikave të disiplinimit pozitiv ku fëmijët pranojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin; me interesimin e mësuesit për t'u përditësuar me metodologjitë ndërvepruese të mësimdhënies me qëllim zbatimin cilësor të

¹ "Supporting teacher competence development, for better learning"

kërkesave të reja kurrikulare; me përdorimin e metodave të larmishme të vlerësimit të të nxënësve, si dhe me krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe efektive në shkollë ndërmjet drejtuesve, stafit pedagogjik, prindërve dhe përfaqësuesve të komunitetit.

Për secilën standard është bërë një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes dhe më tej janë dhënë treguesit specifikë të përmbushjes së tij.

Standardi 1. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional

Standardi 2. Zotërimi i përmbajtjes së dokumentacionit kurrikular

Standardi 3. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës

Standardi 4. Pranimit dhe respektimi i diversitetit

Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies

Standardi 6. Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit

Standardi 7. Zbatimi i kodit të etikës

2.3 Standardet profesionale të mësuesit të ciklit fillor

Standardi 1. Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional

1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor interesohet dhe merr pjesë në veprimtari që janë të lidhura me aspekte të ndryshme të zhvillimit profesional. Këto veprimtari mund të jenë të iniciuara nga vetë ai, të kërkuara nga institucioni shkollor ose të diktuar nga nevoja për trajnim dhe kualifikim të vazhdueshëm.

Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional ka lidhje me njohjen dhe respektimin me përgjegjshmëri të kërkesave të Legjislacionit arsimor dhe dokumentacionit shkollor.

1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1.** zotëron ligjin “ Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe dispozitat normative të këtij sistemi;
- 1.2.2.** zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit;
- 1.2.3.** zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore, për personelin e shkollës dhe për përmirësimin e procesit të

| | |
|----------------|---|
| | mësimdhënie-nxënies; |
| 1.2.4. | <i>zbaton etikën profesionale të mësuesit;</i> |
| 1.2.5. | <i>respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</i> |
| 1.2.6. | <i>respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</i> |
| 1.2.7. | <i>demonstron përkushtim dhe dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës;</i> |
| 1.2.8. | <i>harton një plan të qartë afatgjatë për zhvillimin e vet profesional;</i> |
| 1.2.9. | <i>diskuton me të tjerët dhe ndan mendime për çështje të ndryshme profesionale;</i> |
| 1.2.10. | <i>kërkon e shfrytëzon literaturë profesionale, si dhe burime të shumta informacioni, duke siguruar një plan zhvillimi profesional për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit;</i> |
| 1.2.11. | <i>shkëmben dhe ndan përvoja me kolegë dhe reflekton ndaj ideve të reja;</i> |
| 1.2.12. | <i>respekton konfidencialitetin dhe zbaton standarde të larta etike, ligjore që kanë në qendër fëmijën dhe familjen e tij, duke siguruar një kulturë bashkëpunuese dhe klimë pozitive brenda dhe jashtë mjedisit fizik të shkollës;</i> |
| 1.2.13. | <i>ndihmon një mësues të ri për zgjidhjen dhe kapërcimin e vështirësive të ndryshme profesionale;</i> |
| 1.2.14. | <i>zgjedh dhe merr pjesë në atë veprimtari profesionale që lidhet me profesionin e mësuesisë;</i> |
| 1.2.15. | <i>dëshmon përmirësim në arritjet profesionale.</i> |

Standardi 2. Zotërimi i përmbajtjes së dokumentacionit kurrikular

2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor zotëron përmbajtjen e paketës kurrikulare në të cilën përfshihen: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe programet lëndore nga klasa e parë deri në klasën e pestë.

Në bashkëpunim me nxënësit, mësuesi përmbush rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe dhe të kompetencave të fushave të të nxënit. Në përgjithësi, mësuesi i ciklit fillor i jep të gjitha lëndët, me përjashtim të gjuhës së huaj. Si rrjedhojë, ai vlerësohet nëse jep mendimet dhe sugjerimet e duhura për përmirësimin e dokumentacionit kurrikular.

2.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

2.2.1. *qëndron i mirinformuar për të rejat e reformës kurrikulare, pjesë e së cilës është edhe*



arsimi fillor;

- 2.2.2. *zotëron* konceptet bazë, ligjësitë shkencore dhe i zbaton me saktësi gjatë mësimdhënies, në përshtatje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku jep mësim;
- 2.2.3. *analizon* si përshkallëzohen njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e programeve lëndore nga njëra klasë në tjetrën;
- 2.2.4. *përdor* me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetit të zbatimit të programeve lëndore dhe të integritimit ndërlëndor;
- 2.2.5. *përdor* materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;
- 2.2.6. *përcakton* rezultatet e duhura të të nxënësve për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat (shkathtësitë) e programit;
- 2.2.7. *shpjegon* lidhjen program-tekst-plan mësimor vjetor dhe tremujor;
- 2.2.8. *planifikon* projekte kurrikulare dhe module mësimore;
- 2.2.9. *përzgjedh* mjetet e nevojshme mësimore për të realizuar përmbushjen e kërkesave të programeve lëndore;
- 2.2.10. *ndihmon* nxënësit në ndërtimin e njohurive, nëpërmjet organizimit të situatave të të nxënësve dhe veprimtarive praktike në të gjitha lëndët e ciklit fillor;
- 2.2.11. *diskuton* me kolegët dhe specialistë lëndorë për çështje të ndryshme kurrikulare;
- 2.2.12. *përdor* larmi metodash, teknikash e strategjish duke ia përshtatur natyrës dhe specifikave të lëndëve të ndryshme të ciklit fillor;
- 2.2.13. *përfshin* nxënësit në veprimtari që kanë rezultate të dukshme të nxënësve;
- 2.2.14. *njih* dhe *përdor* mjete teknologjike për zhvillimin e rrugëve të përshtatshme që lehtësojnë zotërimin e koncepteve lëndore.

Gjuhët dhe komunikimi

Përmbush rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës “Gjuhët dhe komunikimi”:

- të dëgjuarit e teksteve të ndryshme;
- të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar;
- të lexuarit e teksteve të ndryshme;
- të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale;
- përdorimi i drejtë i gjuhës.

Matematika

Përbush rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës “Matematika”:

- zgjidhja e situatës problemore;
- arsyetimi dhe vërtetimi matematik;
- të menduarit dhe komunikimi matematik;
- lidhja konceptuale;
- modelimi matematik.

Shkencat e natyrës

Përbush rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës “Shkencat e natyrës”:

- identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre;
- përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore;
- komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës.

Shoqëria dhe mjedisi

Përbush rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”:

- personale, sociale, qytetare;
- kërkimi historik, përdorimi i burimeve, shpjegimi dhe komunikimi;
- vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike, mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit, marrja e vendimeve.

Artet

Përbush rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës “Artet”:

- krijimi artistik;
- performimi artistik;
- vlerësimi artistik.

Edukimit fizik, sporte dhe shëndeti

Përbush rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës “Edukimit fizik, sporte dhe shëndeti”:

- zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive;
- ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive;

- përshtatshmëria me një stil jete aktiv e të shëndetshëm.

Teknologji dhe TIK

Përbush rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës “Teknologji dhe TIK”:

- aftësitë njohëse, aftësitë praktike, aftësitë komunikuese;
- kreativiteti dhe inovacioni, komunikimi dhe bashkëpunimi, kërkimi dhe gjetja e informacionit, mendimi kritik, problem-zgjidhës dhe vendimmarrja, mbrojtja.

Standardi 3. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës

3.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor krijon në klasë një mjedis pozitiv gjithëpërfshirës, të sistemuar nga ana fizike dhe me lehtësi për t’u shfrytëzuar nga nxënësit në çdo moment të ditës. Krijon një mjedis të tillë pune, ku diversiteti pranohet dhe çdo fëmijë ndihet i mirëpritur. Në jetën e përditshme zbaton praktika gjithëpërfshirëse dhe nëpërmjet këshillit të prindërve të klasës, por jo vetëm, punon fuqishëm për krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse.

3.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 3.2.1 *krijon* në bashkëpunim me nxënësit një mjedis emocional pozitiv, të ndërtuar mbi rregulla dhe përkujdesje reciproke;
- 3.2.2 *sistemon* mjedisin në mënyrë të tillë, që nxënësit të lëvizin lirshëm nëpër klasë, të mos pengojnë njëri-tjetrin në detyra të caktuara, të mundësojë zhvillimin e punës në grupe të vogla e të mëdha, të organizohen në punë me grupe etj.;
- 3.2.3 *edukon* te nxënësit ndjenjën e të bukurës, të estetikës, të rregullit e të pastërtisë;
- 3.2.4 *siguron* materiale dhe mjete didaktike të sigurta në funksion të mësimdhënies dhe të të nxëniet;
- 3.2.5 *krijon* kushtet e duhura për mësimdhënie me ndihmën e kontributeve të prindërve;
- 3.2.6 *eksponon* në vende të dukshme punët individuale të nxënësve ose punimet e përgatitura në grup;
- 3.2.7 *përdor* ngjyra për të tërhequr atë sa duhet vëmendjen e fëmijëve;
- 3.2.8 *kujdeset* për ndriçimin e mjaftueshëm të klasës dhe për ajrosjen e mjedisit;

- 3.2.9 kujdeset për t'i kënaqur fëmijët me uljen në banka duke mbajtur parasysh diferencat fizike, sociale, akademike, interesave, stilit të të nxënësve, ndihmën ndaj shokut etj.;
- 3.2.10 përdor teknikat e menaxhimit të klasës dhe të disiplinimit pozitiv që nxësin vetëkontrollin dhe vetëdisiplinën;
- 3.2.11 shfaq përkushtimin e tij të vazhdueshëm në përmirësimin e kushteve të klasës;
- 3.2.12 krijon hapësira të sigurta fizike dhe emocionale ku nxënësit ndihen pjesë e saj dhe motivohen të marrin përsipër iniciativa dhe risqe, të bëjnë gabime dhe të kërkojnë alternativa të tjera zgjidhjeje.

Standardi 4. Pranimi dhe respektimi i diversitetit

4.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor ndikon në zhvillimin cilësor të të gjitha marrëdhënieve brenda klasës. Ai i mbështet dhe i ndihmon nxënësit të kenë sukses duke ia bërë shkollën më të këndshme, më bashkëpunuese dhe duke krijuar besim në forcat e tyre.

Mësuesi i ndërton marrëdhëniet me nxënësit duke u bazuar në njohjen e psikologjisë së zhvillimit të fëmijëve 6-11 vjeç, të aftësive, interesave dhe vlerave të tyre. Ai zotëron njohuri rreth inteligjencës së shumëfishtë, stileve të të nxënësve dhe zhvillon një mësimdhënie gjithëpërfshirëse, nxitëse dhe përfituese për të gjithë nxënësit.

4.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 4.2.1 mban parasysh faktin se çdo nxënës është sa unik aq sa është dhe pjesë e bashkësisë së nxënësve të klasës;
- 4.2.2 pranon dhe mban parasysh ndryshimet ndërmjet nxënësve, por gjithashtu shfrytëzon të përbashkëtat që ofron një grup i caktuar nxënësish;
- 4.2.3 u mëson nxënësve parimet demokratike të lirisë, të drejtësisë dhe barazisë duke i ndihmuar të kapërcejnë diskriminimet, paragjykimet, dhe stereotipet e krijuara kur i ndeshin në shkollë ose jashtë saj;
- 4.2.4 mbështet përgjegjësitë personale dhe shoqërore tek nxënësit duke siguruar marrjen e vendimeve së bashku, vendosjen e rregullave duke inkurajuar nxënësit të përcjellin këto veprimtari sociale edhe në komunitetin ku jetojnë;

- 4.2.5 mundëson rrugë të ndryshme për zgjidhjen e konflikteve ose të situatave të vështira brenda klasës;
- 4.2.6 është vëzhgues intensiv i marrëdhënieve dhe veprimeve të nxënësve në orët mësimore dhe në veprimtaritë jashtëshkollore;
- 4.2.7 ndërhyt me takt në një marrëdhënie ndërmjet fëmijëve kur shikon se situata përkeqësohet;
- 4.2.8 nxit zhvillimin e një atmosfere sa sociale, aq edhe të pasur me vlera etike.
- 4.2.9 zbaton strategji që u përgjigjen diversitetit të nxënësve;
- 4.2.10 mbështetet në pikat e forta të çdo nxënësi dhe mbi këtë bazë ndërton mësimdhënien me nxënësin në qendër;
- 4.2.11 dallon fëmijët që janë me aftësi të kufizuar nga fëmijët me vështirësi në të nxënë;
- 4.2.12 harton plane edukative individuale të bazuara në arritje;
- 4.2.13 bashkëpunon me kolegë dhe me specialistë për zhvillimin e talenteve të nxënësve;
- 4.2.14 krijon klimë bashkëveprimi dhe bashkëpunimi që vlerëson dinjitetin e nxënësve të klasës.

Standardi 5. Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies

5.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor e planifikon dhe e zhvillon mësimdhënien bazuar në psikologjinë moshore të nxënësve, teoritë e të nxënësve, modelet e mësimdhënies dhe në kërkesat e kurrikulës zyrtare. Në veprimtaritë e përditshme mësimore, mësuesi përdor strategji të larmishme mësimdhënieje që nxisin të menduarit kritik e krijues të nxënësve, shprehitë e zgjidhjes së problemeve, të nxënësve aktiv, ndërveprimin pozitiv social etj.

5.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 5.2.1 është njohës i mirë i aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënësve dhe i psikologjisë moshore të nxënësve me të cilët punon;
- 5.2.2 njeh teoritë kryesore të të nxënësve dhe modelet e mësimdhënies;
- 5.2.3 analizon elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë tipet e mësimdhënies me njëra-tjetrën;
- 5.2.4 shfrytëzon literaturën bashkëkohore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënësve;

- 5.2.5 *menaxhon* situata, sjellje dhe veprime të ndryshme të nxënësve;
- 5.2.6 *planifikon* orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;
- 5.2.7 *zbaton* metodat ndërvepruese të mësimdhënies në përshtatje me lëndën, temën e mësimin, rezultatin e të nxënit dhe me moshën e nxënësve;
- 5.2.8 *përdor* metoda të larmishme mësimdhënieje që japin rezultate pozitive të nxënësit;
- 5.2.9 *prezanton* materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike;
- 5.2.10 *planifikon* veprimtari që nxisin të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve;
- 5.2.11 *përdor* metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;
- 5.2.12 *punon* me prindërit për përmirësimin e përparimit të nxënësit;
- 5.2.13 *krijon* balanca ndërmjet punës individuale, punës në grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën.

Standardi 6. Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit

6.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor vlerëson vazhdimisht pasi vlerësimi është pjesë e të nxënit dhe e mësimdhënies së përditshme. Ky proces realizohet duke dëgjuar dhe vëzhguar nxënësit gjatë kryerjes së detyrave, duke vëzhguar atë që shkruajnë dhe bëjnë, duke marrë parasysh përgjigjet e pyetjeve etj. Mësuesi përpiqet t'i njohë më mirë nxënësit, të ndërtojë një profil të progresit të tyre, të njohë pikat e forta dhe nevojat, të cilat i përfshijnë në planifikimin e veprimtarive të ndryshme mësimore.

Mësuesi përdor shumëllojshmëri instrumentesh dhe strategjish të përshtatshme vlerësimi për të monitoruar dhe vlerësuar nxënësit. Ai monitoron në mënyrë sistematike nxënësit për të kapur në kohë vështirësitë apo problemet e të nxënit. Mësuesi realizon vlerësime formale dhe joformale për t'u bindur për arritjet, dobësitë dhe mangësitë e nxënësve dhe për të hartuar planet e ndërhyrjeve të menjëhershme.

6.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1 *është* njohës i mirë i kornizës së vlerësimit në arsimin parauniversitar;
- 6.2.2 *mban* parasysh parimet themelore mbi të cilat mbështetet vlerësimi;
- 6.2.3 *e përqendron* vlerësimin në zbatimin e standardeve dhe pritshmërive të progresit dhe

arritjes së nxënësve në njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e përcaktuara në kurrikulën shkollore;

6.2.4 *i motivon* nxënësit për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë;

6.2.5 *krijon* dhe përshtat teknika vlerësimi që i përgjigjen zhvillimit individual të nxënësit në përputhje me programin mësimor;

6.2.6 *përdor* mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve;

6.2.7 *vëzhgon* dhe vlerëson me përshkrim ecurinë dhe përparimin e nxënësit, duke përdorur instrumente të ndryshme;

6.2.8 *krijon* portofolin e të nxënit për çdo nxënës, në të cilin *dokumentohen* detyra e punime të nxënësve që dëshmojnë përparimin dhe interesin e tyre për mësimin, jetën, prirjet dhe interesat e tyre;

6.2.9 *mban* statistika të përditësuara për përparimin e nxënësve;

6.2.10 *jep* në kohë komente të dobishme me gojë dhe me shkrim për nxënësit;

6.2.11 *nxit* vetëvlerësimin dhe vlerësimin e nxënësve për njëri-tjetrin duke përdorur kritere të mirëpërcaktuara;

6.2.12 *bashkëpunon* me prindërit jo vetëm për t'i njohur me vlerësimet, por edhe për të marrë informacion prej tyre;

6.2.13 *monitoron* efektivitetin e mekanizmit të feedback-ut të marrë nga nxënësit, prindërit dhe kolegët.

Standardi 7. Zbatimi i kodit të etikës

7.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i ciklit fillor vepron me respekt, integritet dhe në mënyrë etike kudo që ndodhet, brenda dhe jashtë mjediseve të shkollës.

7.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

7.2.1 *është* njohës i mirë i kodit të etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat;

7.2.2 *zbaton* rregullat e etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë

punën e mësuesit;

7.2.3 *njeh* rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;

7.2.4 *kryen* me ndershmëri punën e tij si edukator i brezit të ri;

7.2.5 *krijon* besueshmëri dhe respekt nëpërmjet sjelljeve dhe vlerave të tij;

7.2.6 *përmbush* detyrimet ligjore dhe kontraktuale;

7.2.7 *i trajton* nxënësit, prindërit, kolegët dhe drejtuesit me respekt, drejtësi dhe me dinjitet;

7.2.8 *mbron* të drejtat dhe raportet konfidenciale të nxënësve, kolegëve dhe në lidhje me stafin;

7.2.9 *sillet* në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor;

7.2.10 *vishet* me veshjen e duhur si në shkollë edhe jashtë saj;

7.2.11 *i trajton* nxënësit me respekt dhe dinjitet;

7.2.12 *krijon* një mjedis pozitiv që përcjell vlerat themelore të demokracisë.